



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenet 15, 24 dhe 64, në bazë të Rregullës Zgjedhore Nr.8/2013 për Certifikimin i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre, si dhe në përputhje të plotë me Vendimin nr. 1661-2021 për miratimin e planit operacional për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do mbahen me 17 tetor 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 03.09.2021, nxjerr këtë:


Udhëzues

Për Shortin për Renditje të Subjekteve Politike të Certifikuara në Fletëvotimin për Zgjedhjet Lokale për Republikën e Kosovës që do mbahen më 17 tetor 2021

- I. Ky udhëzues ka për qëllim të përcaktoj procedurat që duhen respektuar gjatë tërheqjes së shortit për renditjen e subjekteve politike në Fletëvotimin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me 17 tetor 2021, si në vijim;
 - a. Shorti i renditjes së subjekteve politike të certifikuar në fletëvotim mbahet më 8 shtator 2021, në ora 10:00.
 - b. Kryesuesi i KQZ-së, kryeson procesin e tërheqjes së shortit dhe siguron që tërheqja e shortit është e drejtë dhe transparente.
 - c. Zëdhënësi i KQZ-së moderon ceremoninë e tërheqjes së shortit për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim.
 - d. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, i njofton subjektet politike të certifikuar për vendndodhjen, datën dhe kohën, në të cilën shorti i renditjes në fletëvotim do të mbahet.
 - e. Secili subjekt politik i certifikuar, dërgon nga një përfaqësues për të tërhequr shortin dhe vëzhguar mbajtjen e shortit te fletëvotimit.
 - f. Nëse subjekti politik, nuk e dërgon përfaqësuesin në tërheqjen e shortit, një anëtar i përzgjedhur nga Sekretariati i KQZ-së e tërheq shortin për atë subjekt politik.
 - g. Emrat e subjekteve politike të certifikuar për të marrë pjesë në zgjedhje, do të futen në topa të mbyllur dhe do të vendosen në një vazo të veçantë.

- h. Numrat rendor aq sa ka subjekte politike të certifikuara për të marrë pjesë në zgjedhje, dhe duke filluar nga numri 101, janë të shtypur në letër, të futur në topa identik, të mbyllur dhe të vendosur ne një vazo.
- i. Drejtori i Zyrës do të tërheqë topat me emrat e subjekteve politike të certifikuara dhe kështu cakton radhën e përfaqësuesve të subjekteve politike të certifikuara për të tërhequr numrin e vet në fletëvotim.
- j. Përfaqësuesi i autorizuar i subjektit politik tërheqë nga vazo topin me një numër rendor në të. Numri i tërhequr do të jetë numri i atij subjekti politik në fletëvotim.
- II. Obligohet Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim për zbatimin e këtij vendimi;
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve


Kreshnik Radoniqi, Kryesues

